



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:129681

Datë: 12.08.2022

Numri i dokumentit: 03324022

**P.nr.49/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Nazmije Maxhera, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit B.M., nga S.i E., rr.”D. M.”, nr....., për shkak të veprës penale *Rrezikim i trafikut publik* nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Nexhat Beqiri, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4590/2018 të datë 24.01.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar të datës 11.08.2022, në praninë prokurorit të shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit të të pandehurit, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 12.08.2022 e përpiloi këtë:

### **AKTGJYKIM**

**I PANDEHURI: B. M.** nga babai Sh. dhe e ëma Sh. e vajzërisë D. i lindur me ..., me vendbanim në fshatin S. i E. Komuna V. me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

### **ËSHTË FAJTORË**

**SEPSE:** me datën 21.09.2014 rreth orës 14:30 minuta, në fsh.S. i Epërm komuna e V. derisa i pandehuri ishte duke drejtuar automjetin e tipit ‘‘WV-Golf ‘‘, ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit ....., nga pakujdesia shkel ligjin për sigurinë në komunikacionin rrugorë 02/L-70 neni.62.2, në atë mënyrë që duke mos iu dhënë përparësi automjetit i tipit ‘‘O.K.’’ ngjyrë të zezë me targa 01-151-DP, të cilën e drejtonte H. H., me të arritur në kryqëzimin e rrugës së lartëshënuar i njëjti merrë veprimin e kyçjes , ku në ato momente nga drejtimi i fsh.S. në drejtim të fshatit B. ka qenë duke levizur automjeti ‘‘ O.K.’’ i cili në pamundësi të ndaljes për shkak të ndaljes së befasishme të automjetit ‘‘G....’’ të cilin e voziste i pandehuri, e godet me pjesën e parë të anës së djathtë në pjesën e parë anësore të anës së majtë automjetin ‘‘O.’’, ku si rezultat i aksidentit për veç dëmeve materiale lëndime trupore pësojnë H. H. dhe atë thyrje të qafës kirurgjike të kockës të krahut të dorës së djathtë të shkaktuar nga veprimi i mjetit të fortë mbrehtës (jo i mbrehtë, i topitur) që si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore.

**Me këtë ka kryer veprën penale *Rrezikim i trafikut publik* nga neni 378 par.8 lidhur me par.6.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75, 76 si dhe 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 453, 463 të KPPK-së:

### **I CAKTON**

Të pandehurit **B. M.**, dënim burgu në **kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh.**

Me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 47 të KPRK-së, gjykata të pandehurit dënimin me burgim ia zëvendëson në:

### **DËNIM ME GJOBË**

Me të cilin të pandehurin **B. M.** gjykata e gjykon me dënim **me gjobë në shumën prej 900 (nëntëqind) euro**, të cilin i pandehuri detyrohet që ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do të shndërrohet në dënim me burgim, ku 1 (një) ditë burgim do të jetë e barabartë me 20 (njëzet) euro gjobë.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **20 (njëzetë) euro**, në emër të përpilimit të ekspertizës së komunikacionit shumën prej **40.88 (dyzet e tetëdhjetë e tetë) euro**, në emër të përpilimit të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej **50 (pesëdhjetë) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 (tridhjetë) euro**. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

#### *Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4590/2018 të datë 24.01.2019, kundër të pandehurit B. M. me vendbanim në fshatin S. i E., Komuna V., për shkak të veprës penale *Rrezikim i trafikut publik* nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 e 1 të KPRK-së. Gjukata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale me datë 11.08.2022, në të cilën seancë kanë marrë pjesë, prokurori i shtetit Arjan Xhema, i pandehuri B. M. personalisht, dhe mbrojtësi i të pandehurit av. Nexhat Beqiri.

#### *Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar*

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 11.08.2022, gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij në këtë çështje penale, pas kësaj, gjykata e ka ftuar prokurorin e shtetit që t'ia lexojë aktakuzën të pandehurit. Prokurori i shtetit për shkak të zbatimit të dispozitës nga neni 3 i KPRK-së, përkatësisht zbatimit të ligjit më të favorshëm, pas leximit të aktakuzës ka deklaruar se heqë dorë nga pjesa e dispozitivit të aktakuzës që ka të bëjë me të dëmtuarën S. M., përkatësisht pjesës së dispozitivit që ka të bëjë me lëndime të lehta trupore. Pas leximit ta aktakuzës së ndryshuar nga ana e prokurorit të shtetit, dhe pas konsultimeve të mjaftueshme, si dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarojë lidhur me fajësinë.

Lidhur me pranimin e fajësisë i pandehuri ka deklaruar se **e pranon në tërësi fajësinë** sipas aktakuzës së ndryshuar të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe ka theksuar se ky aksident ka qenë pa dashjen e tij, se zakonisht në vozitje është i qetë, por atë ditë ka qenë në një darsëm, se e di se nuk ka qenë duke zhvillu shpejtësi të madhe pasi që ka qenë duke u kyçur në rrugë por që ka ardhur deri te ky aksident për çka edhe i vije keq që ka ndodhur, por që në të njëjtën kohë është falënderues që nuk ka ndodhur diçka më e keqe.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Nexhat Beqiri lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se e konfirmon se klienti i tij pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare siç parashihet me ligj pas konsultës dhe sqarimit në detaje lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit

të fajësisë, dhe ka shtuar se siç e ka theksuar edhe i pandehuri, ai rastësisht është gjendur në rrethana të tilla që nuk ka mundur të ju ikë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë se të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që pranimi është bërë në baza vullnetare, pa presion, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe është i mbështetur në faktet dhe provat të cilat i përmban aktakuza, ndërsa gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtorë dhe ta gjykoj sipas ligjit dukke marrë parasysh që pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Pas pranimit të fajësisë, gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtin e ka njoftuar me favoret dhe disfavoret e pranimit të fajësisë dhe me dënimet e parapara me nenin 378 par.8 lidhur me par.6 e par.1 të KPRK-së, por që i pandehuri edhe pas këtyre paralajmërimeve ka deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës.

#### *Provat e vlerësuara nga gjykata*

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 248 të KPP-së, dhe ka konkluduar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndes dhe atë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2014-BD-984, i datë 21.09.2014, procesverbali mbi intervistimin e ankuesit – dëshmitarit B. M. i datë 21.09.2014, procesverbali mbi intervistimin e ankuesit – dëshmitarit H. H. i datë 21.09.2014, foto-dokumentacioni në katër shtojca, raporti i policit i datë 21.09.2014, raporti i aksidentit të komunikacionit i datë 21.09.2014, procesverbali mbi marrjen në pyetje e të dyshuarit B. M., i datë 22.01.2019, akt ekspertimi mjeko-ligjor i Dr.V. H., i datë 12.01.2019, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor A. M., i datë 04.01.2019, dokumentacioni mjekësor, si dhe shkresat e tjera të lëndes. Të gjitha këto prova vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin mbi pranimin e fajësisë e ka pranuar.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë nga i pandehuri, keqardhjen e thellë të shprehur, shkallën e përgjegjësisë penale, ashtu që në rastin konkret vepra është kryer nga pakujdesia, si dhe premtimin e të pandehurit që do të jetë më i kujdesshëm në komunikacion, seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri e ka përcjell me vëmendje, si dhe ka pasur sjellje korrekte gjatë gjykimit. Sa i përket rrethanave rënduese gjykata mori parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur ndërsa rrethana të tjera rënduese gjykata nuk gjeti.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës për veprën penale *Rrezikim i trafikut publik* nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 e par.1 të KPRK-së, ka paraparë dënimin me burgim prej 6 (gjashtë) muaj, deri në 5 (pesë) vite.

Gjykata ka vlerësuar se të pandehurit mund t'i zbutet dënimi konform dispozitave të neneve 75 dhe 76 të KPRK-së, pasi që në bazë të rrethanave lehtësuese të lartcekura, e sidomos faktit se vepra penale është kryer jo me dashje por nga pakujdesia, të njëjtat janë rrethana të mjaftueshme që përmbushin kushtin e përcaktuar me dispozitën e nenit 75 par.1 pika 1.2, e cila shprehimisht

thotë se gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit “kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë”. Andaj në pajtim me dispozitën e nenit 76 par.1 pika 1.6 gjykata të pandehurit i ka caktuar dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj. Ndërsa në përputhje me nenin 47 të KPRK-së, ka vlerësuar se të pandehurit mund t’i zëvendësojë dënimin me burgim në dënim me gjobë, ashtu që pas marrjes së pëlqimit nga ana e të akuzuarit të njëjtit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë mori parasysh rrethanat e lartcekura lehtësuese, kështu që gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 41 të KPRK-së, dhe çdo dënim tjetër nuk do të kontribuonte risocializimit dhe ri integritetit të tij si disa nga qëllimet kryesore të dënimit. Andaj me pranimin e të gjitha këtyre rrethanave, e në vështrim të dispozitave të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75, 76 si dhe 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së, gjykata vlerësoi se nuk ka pasur vend që të pandehurit t’i shqiptohet dënim më i rëndë, dhe edhe me këtë dënim ndaj të pandehurit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitat e nenit 41 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t’i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

*Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit*

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në bazë të nenit 450 dhe 453 të KPPK-së, vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e mori në bazë të nenit 463 par.2 të KPPK-së, ndërsa, vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga të lartë cekurat e bazuar në nenin 365 të KPPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI**

**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**

**P.nr.49/19, datë 12.08.2022**

**Zyrtarja ligjore  
Nazmije Maxhera**

**Gjyqtari i vetëm gjykues  
Ferki Xhaferi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.